



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:139923
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05512953

Ac.nr.7321/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. U. nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Veton Uka, avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Vushtri (DKA), të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtari i Komunës në Vushtri, Bastri Duraku, për kompensimin e shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.596/2023, të datës 20.10.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Vushtri, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.596/2023, të datës 20.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.596/2023, të datës 20.10.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadija e paditëses A. U. nga Vushtrria. II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses t'i kompensoj shujtat ditore dhe atë nga data 09.11.2021 e deri me datë 20.11.2022, për 193 ditë pune t'ia paguaj shumën në vlerë prej 386.00 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 22.06.2023 e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. III. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë, për padi shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta anulojë dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore apo ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të të paditurës më propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja A. U. nga Vushtrria, përmes të autorizuarit të saj, me datë 22.06.2023, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me pretendimet se e njëjta është e punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHFMU "A. F." në D. si mësimdhënëse dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, paditëses i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë (më detajisht si në padi në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.596/2023, të datës 20.10.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjyqimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se "mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, kontestuese nuk ishte as prania e paditëses në punë, kontestuese nuk ishte po ashtu as rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë, por kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditëses, gjë që vërtetohet edhe nga përgjigja në padi e të paditurës. Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU "A. F.i" Druar-Vushtrri, nga vërtetimi i lëshuar me numër të protokollit 26 i datës 17.03.2023 nga SHFMU "A. F." Druar-Vushtrri, vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune si dhe vijueshmëria në punë e paditëses nga data 09.11.2021 deri me datë 20.11.2022, periudhë për të cilën paditësja kërkon kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, gjithsejtë 193 ditë.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e lidhur me nenin 87 të Ligjit të Punës. Lidhur me kumatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së derisa për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 452 të LPK-së. Po ashtu lidhur me vendosjen jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditëses dhe nuk ka bërë tejkallim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditësja për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar ka qenë në vendin e punës. Po ashtu nuk janë kontestuese ditët e pranisë së paditëses në punë për të cilën periudhë kohore kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shujtës ngase paditësja A. U. është në marrëdhënie pune me të paditurën, përkatësisht është e punësuar në SH.F.M.U “A. F.” në D., Komuna Vushtrri, si mësimdhënëse dhe kjo provohet përmes Vërtetimit me Nr.26, të datës 17.03.2023, lëshuar nga e paditura dhe se për periudhën nga data 09.11.2021 e deri më datë 20.11.2022, ka gjithsej 193 ditë pune.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë

kolektive...”. Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: “Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy €) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023“.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditëses t’i paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili përcakton se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës ”*, ashtu që paditësja padinë e ka parashtruar me datë 22.06.2023 dhe kërkesën e saj e ka paraqitur për vitet 2021 deri 2022, siç është përcaktuar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ashtu që kërkesa e të njëjtës nuk është parashkruar dhe si e tillë është paraqitur brenda afatit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7321/2023, më datë 27.03.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj